

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Superhero

Mosha

Periudha zhvillimore (nga 3 deri në 10 vjet)

Vendi / lokacioni

Vlera e karakterit

Kushte shtëpie

Përfytyrshmëri

Koha e nevojshme për përgatitje

Потребно време за реализација

10 minuta

20-25 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet fantazia dhe krijimtaria fëmijore, të pasurohet e të fisnikërohet bota emocionale e fëmijës, si dhe të nxitet që ta shfaq gëzimin dhe kënaqësinë nga puna e mbaruar me sukses.

Rezultate të pritshme

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Përgatitje e materialeve për lojë (materiale të ndryshme nga tekstili, facoleta, ngjitës, ngjyra, lugë druri etj.).

Instrukcione / kahje për lojën

Në këtë lojë fëmijës i jepen materiale të ndryshme me çka fëmija ka për detyrë të bëjë një Superhero. Fëmijës i jepen kahje se superheroi mund të bëhet në lugë druri, të vizatohet në letër etj. (fëmija mund të japë edhe ndonjë tjetër ide), e, pastaj, nga tekstili ose facoleta të



bëhet veshja dhe të ngjitet në letër ose të qepet në lugën e drurit.

Aktivitet / lojë

Me fëmijën bisedohet për superheronjtë dhe çfarë superheroi dëshiron të jetë vetë ai. Ata bashkërisht e vendosin çfarë superheroi do të bëjnë, cilat janë superfuqitë e tij. Pastaj, bashkërisht e punojnë në fletë letre, gjegjësisht e vizatojnë fytyrën, e pastaj nga tekstile të ndryshme (të cilat i dizajnojnë, i presin dhe i ngjesin si veshje), e bëjnë superheronë, të cilit i japin edhe një emër special.

Ky aktivitet mund të bëhet edhe me lugë druri (ku fytyrë do jetë pjesa ovale e lugës, ndërsa nga tekstili do të punohet kostumi dhe pelerina e heroit, të cilat duhet të qepen). Pastaj duhet të gjithë anëtarët e familjes të sajojnë një rrëfim për superheronë e ri.

Shtojca	Materiale
	Fletë letre; ngjitës; tekstile të ndryshme; façoleta; pe dhe gjilpërë; fllomasterë

Aktiviteti është përparitur nga edukatorët:

Krijuar nga: Sonja Çallovaska, Vesna Peceva
Dizajni grafik: Katerina Nikolovska

